

27 Shkurt, 2024

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Diplomimi i shkollës së mesme dhe përgatitja për sukses në kolegji, në karrierë dhe jetë është një moment historik i rëndësishëm për fëmijën tuaj. Pavarësisht nga mosha e fëmijës suaj, nuk është kurrë herët për të filluar të mbështesni rrugën e tyre drejt diplomimit.

Me mbylljen e periudhës së 3 - të shpërndarjes së dëftësave shkollore, dua t'u kujtoj prindërve, kujdestarëve se tani është një kohë e shkëlqyer për të rishikuar përparimin akademik përpara se dëftësat e notave të publikohen në fillim të Prillit. **Është gjithashtu një mundësi e shkëlqyer për të rishikuar përparimin e fëmijës suaj drejt diplomimit, pavarësisht nga mosha e tyre!** [Fletushka "What Families Can Do"](#) / ["Çfarë mund të bëjnë familjet"](#) shpjegon disa mënyra të rëndësishme që ju mund të mbështesni rrugën e fëmijës suaj drejt suksesit të diplomimit.

Konkretisht për prindërit e gjimnazistëve:

1. Përdor këtë "[Graduation Checklist](#)" **Lista Kontrolluese e Diplomimit** për të siguruar që kërkesat janë përmbushur dhe/ose janë në rrugën e duhur për t'u përmbushur.
2. Rishikoni udhëzuesin hap pas hapi për të hyrë në statusin e diplomimit të studentit, i gjetur [këtu](#), për të nxjerrë një raport dhe për të parë detajet akademike të fëmijës suaj.
3. Numëroni kreditet. Nëse vëreni se fëmija juaj është jashtë rrugës së diplomimit, caktoni një konferencë me shkollën e tyre për të diskutuar një plan.
4. Sigurohuni që kurset dhe programi i fëmijës suaj të jenë në përputhje me njërën prej [Pathways to Graduation /Rrugët drejt Diplomimit](#). Rregulloni sipas nevojës me ndihmën e mësuesve dhe këshilltarëve të shkollës.

Nëse keni pyetje të përgjithshme, mund të vizitoni një ngjarje Pop-Up të Diplomimit për t'u takuar me një Ambasador të Diplomimit (shih orarin [këtu](#)) ose mund të kontaktoni ekipin e rrugëve drejt diplomimit në [gradreq@philasd.org](mailto:gradreq@philasd.org). Informacione shtesë, burime dhe mundësi angazhimi gjenden në faqen e internetit të diplomimit të Drejtorisë - [www.philasd.org/graduate](http://www.philasd.org/graduate).

**Ne jemi partnerët tuaj në suksesin e fëmijës suaj!** Faleminderit për partneritetin me ne për të ndihmuar në përgatitjen e të gjithë studentëve për të imagjinuar dhe realizuar çdo të ardhme që dëshirojnë!

Sinqerisht,

Jermaine Dawson, Ed.D.  
Inspektor i Shërbimeve Akademike  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias